

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**, Gjyqtarja Lirije Kafexholli me sek.juridike Belkize Gashi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Bedri Rifat Berisha nga Suhareka, për shkak të vepres kundërvajtëse nga neni 17.1.3 të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik, e në bazë të nenit 73,195 dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me datë, 14.03.2013 merrrë këtë:

### AKTVENDIM

**I PANDEHURI:** Bedri Rifat Berisha lindur me dt. 01.04.1978 në Suharekë Rr."Reshtanit", ku dhe tani jeton, i martuar i ati 4 femije, ka të kryer fakultetin, politelog, gjerë me tani kinse jo i denuar.

### ËSHTË PËRGJEGJES

Sepse si Zyrtar i lartë publik – Këshilltar Suharekë nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë së tij për vitin 2009 deri me 31.03.2010 në Agjencionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik e të njejt:

### GJOBITET

Me gjobë në të holla në shumë prej 400 (Katerqindë) EURO të cilin ka për ta paguar brenda 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij Aktvendimi në favor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me nr.gjirollg.1000-4300-7000-0518, pagesa bëhet nëpërmes të kësaj Gjykate.

Nese denimin e caktuar nuk e paguan në afatin e caktuar i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 26 ditësh duke i u llogaritur nga 15 EURO. qdo ditë burgimi.

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse shuma paushalle prej 10 EURO, i paguan i pandehuri në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merrë formën e prerë në favor të Gjykatës Themelore Prizren - Dega në Suharekë – Divizioni për Kundërvajtje.

Me nga një ekzemplar të këtij aktvendimi të njoftohenë palet.

### ARSYETIM

Me kërkesen e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë me nr. 01/2503/12 të dt. 13.07.2012 është ngritur procedura kundërvajtëse, kundër të pandehurit me motivacion se ka kryer kundërvajtje.

Gjykata muar ne pyetje të pandehurin Bedri Berisha i cili ne mbrojtje të vet deklaroi: se është e vertet se gjate kohes sa kamë qenë duke punuar si zyrtar i lartë publik – Drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Zhvillim Bujqësi dhe Pylltari – Suharekë nuk e kamë bërë deklarimin e rregullt vjetor në lidhje me gjendjen e pasurisë në afat të përcaktuar me ligj prej 01 mars deri me 31 mars 2011 në Agjencionin Kundër Korrupsionit, arsya se pse nuk e kamë bërë deklarimin e pasurisë qendron se kamë qenë i preokupuar me punë tjera ku gjatë muajit shkurt dhe mars të vitit 2012 kamë qenë i angazhuar me disa projekte për rregullimin e dokumentacionit për aplikimin në komisionin Evropjan ku keto angazhime i kame patur jashtë zyres gjykates ia prezentoj një shkresë të leshuar nga Kryetari i Komunës - Suharekë me nr.01 nr.16 të dt. 04.12.2012. Deklarimin e pasurisë e kamë bërë me vones me dt. 11.05.2012 pasi që kamë qenë edhe në Shtetet e bashkuar të Amerikes për një vizite zyrtare. Për kete kundervajtje nuk e ndi vetin pergjegjës dhe kerkoj nga gjykata që të më shqiptohet një dënim me l butë ose të lirohem nga pergjegjesia e kundervajtjes pasi që unë nuk kamë patur ndonje qellim të caktuar që mos ta deklaroj pasurinë por e gjithë kjo për arsye zyrtare, kjo është hera e parë që kam kryer keso kundërvajtje.

Gjykata pas vlersimit të të gjitha provave në shqyrtimin kryesor: deklarates se të pandehurit, dhe pas vlersimit të të gjitha shkrësave të cilat gjenden në lende, konstatoj se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 17 paragrafi 1.3 të Ligjit për deklarimin, prejadhjën dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të Zyrtarëve të lartë publik andaj Gjykata të pandehurin e shpalli përgjegjës dhe ia shqiptoj dënimin në të holla në shumë prej 400 EURO me bindje se do të ketë efekt pozitiv tek i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat rënduse dhe lehtësuse të cilat ndikojnë në marrjen e Aktvendimit dhe se mendon edhe me këtë dënim do të arrihet qellimi i dënimt dhe do të ndikoj pozitivisht tek i pandehuri që në të ardhmën të mos përsëris kundërvajtje të natyres së tillë, si rrethan lehtësuse gjykata muar se për here të pare ka kryer këso kundervajtje, se i pandehuri nuk ka pas ndonje qellim që mos ta bëjë deklarimin e pasurisë pasi që i njejt me vones e ka deklaruar pasurin nga arsye se ka qenë i angazhuar me disa pune zyrtare të tij ndërsa si rrethan rënduse gjykata muar peshen e kundervajtjes së kryer.

Me sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi,  
**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**

Sek.juridike  
Belkize Gashi

Gjyqtarja  
Lirije Kafexholli

**UDHEZIME JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi kanë të drejtë ankese i pandehuri dhe parashtresi i kërkeses, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Divizionit për Kundërvajtje, në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij Aktvendimi nepermes kesaj Gjykate.

Gjyqtarja Lirije Kafexholli	
Kryetari i Gjykatës Themelore Prizren - Dega në Suharekë	
ANILI TRAJKOSI	
Dep.	N. Priz.
Dep.	Priz.
Dep.	Priz. No.
Nr. i Dep.	Priz.
Breg. Juridike	Priz.
Nr. pages	Priz.
PRIZRINE	

DPK 03/2265/03  
29.07.13